

DORIAN KEYS
TRANSPLANTI I JETËS
NOVELË FANTASTIKO-SHKENCORE

BOTIMET TOENA

DORIAN KEYS

TRANSPLANTI I JETËS

Novelë fantastiko-shkencore

Përktheu nga origjinali anglisht

Xhimi Lazri

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2020

Autori: Dorian Keys (Dorian Kejs)
Titulli në original: Imprint legacy

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo
Korrektore letrare: Edona Marku
Përkujdesja grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 978-9928-277-78-7

© Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

www.toena.com.al

Një

- Sa e ka numrin shtëpia? - pyeta Stivin dhe vazhdova ta ngisja makinën drejt cepit të rrugës, ku mbi një tabelë lexohej *Evergreen Lane*.

- Këto shtëpi janë larg njëra-tjetrës, ka mundësi të jetë një bllok më tutje, - m'u përgjigj duke shikuar ekranin e GPS-it, pastaj rrugën e errët. - Unë s'e kuptoj si mund t'i gjesh këto shtëpi natën, në këto anë.

U ktheva në rrugëzën e errët, ngadalë, duke kaluar përbri shtëpive ndërsa të dy u përpoqëm të shihnim numrat e adresave.

- Ja tek është, atje, majtas, - tha Stivi, dhe goditi qafën me pëllëmbë, e më pas e vështroi atë me kujdes.

- Për cilën shtëpi e ke fjalën? Këto janë njëlloj të gjitha, - i thashë, dhe ktheva kokën drejt tij. - Po ti, ç'pate kështu? - e pyeta.

- Asgjë, një mushkonjë, - u përgjigj Stivi, duke fshirë dorën me një shami letre që e gjeti në xhepin e derës së makinës. - Është ajo shtëpia me makinën e parkuar pranë saj. E po, diçka e gjetëm, besoj.

Ai shënjoi me dorë për nga rruga në të majtë.

- Shiko sa e madhe ishte, - shtoi dhe më tregoi insektin e shtypur te shamia.

- Ashtu thua? - ia ktheva, duke vështruar rrugën që e ndriçonin dritat e makinës. - Sipas meje, kot e kemi, më duket sikur po kërkojmë fantazma. Federalët duhet ta dinë fort mirë se kjo është një rrugicë qorre dhe ma do mendja që na kanë dërguar enkas në këtë askund.

- Je i bindur? Ej, e pe atë djalin tek ajo pika e karburantit atje në fund? Të ngjau me ndokënd?

- Me ngjau si krimineli i çështjes *big mama*, - iu përgjigja duke vënë buzën në gaz, ndërkohë që po i afrohem shtëpisë që kishte parë ai. - Unë për vete them se do të

bënim mirë të prisnim deri nesër në mëngjes për këtë punë.

Stivi qeshi nën hundë dhe u bë menjëherë serioz.

- Ej, dëgjo pak, - më tha, - po nuk e ndjeve, kthehemi. Federalëve u themi se mbërritëm në hotel më vonë...

Pjesa e pasme e makinës u zhyt në terr, ndërsa nga përpara vinte drita e zbehtë dhe e verdhë e dy llambave që ishin përbri derës së shtëpisë përballë.

- Jo, - ia bëra, - sherifi më tha se ka oficerë që janë duke pritur për telefonatën tonë, në qoftë se i duam... Sidoqoftë, eja shkojmë të shohim njëherë. Gruan e njoftova që do të kthehem në shtëpi nesër. Ti e di, unë mendoj se kjo është një rrugë qorre për këtë çështje.

Ndaluam përpara shtëpisë së ndriçuar dobët, nga dera e së cilës dolën dy burra të veshur me kostume të zeza dhe kapela borsalinë. Hijet e tyre u zgjatën në pjesën e përparme të oborrit. Dera e garazhit ishte e hapur, por nga brenda nuk vinte dritë. Stivi doli nga dera e pasagjerit përbri meje.

Fika motorin. Para se të dilja dhe unë, nxora pistoletën nga këllëfi.

- Kush janë këta tipat?

- Do të jenë federalë, besoj.

- S'ma ha mendja, Klebondi i tha shefit se ata na dërguan ne këtu, s'ka kuptim pse të jenë edhe federalët.

- Zotërinj, - u thirra dy burrave që po rrinin përpara derës së shtëpisë. - Jam detektivi Robert Mirs dhe ky është kolegu im Stiven Enri. Merremi me rastet e rrëmbimeve. A mund të flasim pak bashkë?

Për një çast ata u stepën dhe u duk sikur deshën të fitonin kohë që të kuptonin se ku doja të dilja. Një burrë tjetër, me pantallona të murme dhe çizme muratori, doli nga garazhi duke fshirë duart me një peshqir. Fakti që nuk ishte me kostum dhe republikë si dy të tjerët, e bënte të dukej sikur nuk kishte lidhje me ta.

- Po, patjetër, - u përgjigj ky me zë të lartë, me një theks të fortë gjerman. - Po ju prisnim. Ju lutem hyni!

Po na prisnin? Stiveni tërhoqi armën. Deri atë çast dukej sikur kjo çështje ishte

një pesë me hiç, siç thuhet, kur ja, këta tipat na qenkëshin të gatshëm të bënëin “pak muhabet” me ne.

- Sipas meje, këta duhet të jenë ata që kërkojmë, - tha Stiveni që pas makinës. - Ec përpara, unë po të mbuloj.

Zura të ecja ngadalë dhe vura armën pas, te rripi i mesit.

- Këtu banoni ju zotërinj? - i pyeta.

- Hë për hë, po, - u përgjigj njëri. - Çfarë doni të dini?

- Po kërkojmë një njeri të rrëmbyer dhe hetimet na sollën këtu. A mund të futemi brenda, të hedhim një sy? Dy minuta, jo më shumë.

- Sigurisht, ejani!

Gjithçka po shkonte normalisht, por më ngacmoi dyshimi se gjendja mund të keqësohej. *Ndoshta duhej të kishim ardhur me skuadër më të madhe.*

Duke shkuar drejt derës së hyrjes hodha një sy rrotull. Pas ca gëmushave, te rrugica në të djathtë, qëndronte një fuoristradë e zezë. Në të majtë, dera e garazhit ishte e hapur,

por brenda nuk pashë asnjë makinë. Sytë më zunë vetëm trashalugin me çizme muratori, që rrinte tutje e na shikonte. Përballë meje ishin dy burrat me kostume dhe me kapelë republike. *Po ta mendosh pak mirë, kush mban kapelë republikë sot?* I pari hyri në dhomë dhe mori majtas pragut të derës së bardhë, kurse i dyti i shkoi nga pas duke më zënë rrugën. Pastaj u zhvendos djathtas. Unë vajta prapa tij, duke e përqendruar vështrimin te duart e tij.

Me të kaluar pragun e derës, vura re një burrë të shtrirë mbi një divan, me fytyrën këndeje, nga hyrja. Mbante veshur një rasë nga ato të spitaleve dhe kuptohej që nën të s'kishte gjë tjetër. *Çudi!* Dukej si unë...

Duke ndier që diçka nuk ishte në rregull kapa armën dhe bëra një hap prapa, drejt derës, me mendjen për të dalë. Dy burrat me kostume të zeza u orvatën të më pengonin, kur dëgjova Stivenin të thërriste:

- Ej, ndal, ule armën! Policia, mos lëvizni!

U dhashë një të shtyrë burrave me kapelë republikë, sepse që të dy nxorën nga brezat

ca si punë pajisjesh që m'u dukën si armë. Në një grimë të sekondës, i drejtuan pajisjet nga unë. Qëllova menjëherë burrin në të majtë. Ai ra duke e lëshuar pajisjen përtokë, por përpara se të godisja tjetrin, ky u sul drejt meje. Ia kapa fort dorën ku mbante atë lloj arme dhe u kacafytëm.

Nga pajisja e tij u çlirua një kërcitje e fortë dhe një si hark elektrik u shkëput e ra mbi kanatin prej druri të dritares, që mori zjarr. Duke e mbajtur armën time me dorën e djathtë dhe duke kapur të tijën me të majtën, e shtyva dhe e nxora matanë derës. Atje u rrëzua që të dy përtokë dhe zumë të rrokulliseshim jashtë shtëpisë.

Ia dola të ruaja gjakftohtësinë, e lëshova armën time, me qëllim që të kapja me të dyja duart pajisjen e tij. Për një çast u vështruam sy më sy. Ndërkaq u orvata të largoja nga vetja pjesën e përparme të pajisjes, por sapo e preka, më shkaktoi një dridhje të dorës. Tjetri, i rruar e i kruar, kishte një fytyrë të rregullt, sy të errët, këmishë të bardhë, kravatë të zezë. U përpoqa të ngulisja

gjithçka në mendje. Vazhdova ta ngjeshja përtokë, dhe e hodha vështrimin nga vendi ku kishim lënë makinën.

- Stiven! - bërtita.

- Këtu jam! - u përgjigj ai, duke rendur nga pjesa e errët, drejt ne të dyve, që e vazhdonim kacafytjen përdhe.

I panjohuri, papritur e flaku pajisjen e tij, dhe me goditi me grusht në fytyrë, aq fort, sa u rrokullisa përtokë duke lëshuar armën. Djathtas nesh, pranë garazhit, dëgjova të shtëna. *Të tjerë? Sa vetë të ishin atje brenda? Pa diskutim, duhej të kishim marrë edhe disa policë që të na mbështesnin.*

- Stiven, bjeri telefononit! - i brita ndërkohë që ai po shkonte për t'u mbrojtur te makina e parkuar para shtëpisë, duke qëlluar në drejtim të derës së garazhit. Burri, me të cilin po përleshesha, kapi armën nga toka e vuri në brez dhe rendi për t'u futur brenda në shtëpinë që tani po digjej.

- Jam detektivi Stiven Enri. Na duhen përforcime në *Evergreen Lane*, numri shtatë, - dëgjova të thoshte Stivi.

I lehtësuar që u sinjalizua nevoja për dërgim përforcimesh hodha sytë rrotull në kërkim të armës sime, por nuk e gjeta. Eca gjunjazi, me kujdes, drejt kanatit të derës, duke kontrolluar me vëmendje për çdo shenjë që mund të më linte të kuptoja se burri me kostum të zi ishte duke më pritur. Kur mbërrita te muri, përgjova brenda ku po dergjej tjetri, ai të cilin e kisha vrarë pak më parë. Ishte ende me pajisjen-armë në dorë. Iu afrova dhe ia mora. Stiveni vazhdonte të këmbente zjarr me burrin trashalug.

Arma të përftonte atë ndjesinë e ftohtë që krijojnë dorezat metalike. E drejtova poshtë nga dheu dhe shtypa butonin. Ndjeva që arma u drodh pak dhe andej nga mendoja se duhej të ishte tyta, u çlirua një hark elektrik. Ai ra ekzaktësisht atje ku kisha drejtuar armën, duke ngritur dheun lart dhe duke krijuar një vatër zjarri, si një vrimë që nxirrte tym. Meqë kisha arritur ta përdorja, shkova për nga pragu i derës.

Sapo hyra brenda në shtëpinë që digjej, pashë se burri me kostum të zi ra në gjunjë

përballë divanit, ku po rrinte ai tjetri, që ngjante si unë. Ishte përmendur. Rrinte ulur, me kokën midis duarve.

- Mos lëviz! - i thirra, duke e drejtuar armën nga burri me kostum të zi, kur në atë çast nga jashtë u dëgjuan sërish të shtëna.

- Nuk duam të lëndojmë askënd, - foli ai me një zë të qetë.

- Tregomë duart! - i thashë, me qëllim që ta prangosja dhe ta arrestoja. Në atë çast në dhomë depërtoi tym dhe të dyve na mbyti kolla. Atëherë dëgjova sirenat e policisë, që po afrohej. Burri erdhi pranë meje. Trupin, supet, kokën dhe mënyrën se si rrinte i kisha parë diku. *Atë njeri e kisha takuar edhe herë tjetër.*

- Kthehu dhe vëri duart pas! Nuk ta përsëris më! - e urdhërova.

- Robert, - klithi ai. - Të thashë, nuk kemi ndër mend t'i bëjmë keq askujt.

Desha ta prangosja, por kur iu afrova ai m'u vërsul, më hodhi përtokë. Gjatë rënies e kapa nga dora, e tërhoqa poshtë bashkë me veten. Sapo arrita të ngrihesha mbi njërin

gju, gjithnjë në dyluftim trup më trup me të, ia kapa dorën fort, ia përdrodha, por ai më goditi. Humba drejtpeshimin, u pengova diku dhe u përplasa te një bufë prej druri. Ia dola të ngrihesha në këmbë dhe u përpoqa sërish t'ia kapja krahun. Në vend të krahut, arrita ta kapja vetëm nga mënga e xhaketës.

Ai u shmang, ma la xhaketën në dorë, të cilën e hodha mbi divan, u sula drejt tij, ndërkohë që sirenat dëgjoheshin gjithnjë e më pranë. Duke e ndier se përforcimet thuajse kishin mbërritur, i kapa njërin krah, ia përdrodha fort, duke e detyruar të ulej poshtë me fytyrë nga dyshemeja, me dorën pas qafës. Më në fund, e kisha në një pozicion që mund ta prangosja. Ia vura njëren prangë te kyçi i dorës, por ai u rrotullua në krahun tjetër dhe befas shtiu me armë, më qëlloi në bark.

U plandosa me kurriz. Vështrova drejt territ nga dera e hapur, për ndihmë, pa i lëshuar prangat. Tjetri m'i shqiti nga dora.

- Mos lëviz, - më tha dhe më kaloi diçka rrotull qafës. Desha ta shihja që të mësoja se

çfarë ishte, por kur bëra një përpjekje për të lëvizur, më dhembti i gjithë trupi. Nuk lëviza, vetëm se ndjeva një shkarkesë të vogël elektrike në qafë.

- Sa janë transferuar deri tani? - pyeti dikush, të cilin aty për aty nuk arrija ta shihja.

- Dyzet e dy për qind. Sistemet bazë janë transferuar, por memoria do të kërkojë pak kohë, - u përgjigj dikush tjetër.

- Çfarë ka ndodhur? Ku është Hansi?

- Jashtë. Ortaku i këtij u ndesh ashpër, - u përgjigj ky i fundit, duke vështruar nga unë.

E vetmja gjë që munda të bëja ishte të ngrija kokën e të shikoja burrin me flokë të zinj, të rruar, me të cilin isha përleshur.

- A e morëm trupin?

- Po, po!

Ndërkohë që mes tyre zhvillohej kjo bisedë, sirenat dëgjoheshin gjithnjë e më fort duke u përzier me zhurmën e kërcitjeve të zjarrit.

- Duhet të largohemi tani, përndryshe do të përballemi me autoritetet.

- Dreqi ta marrë! Ksellesiër, thuaji Hansit të bëjë gati makinat e evakuimit.

- Merre këtë. Është i plagosur dhe nuk mund t'i lëmë të dy këtu. Transferimin e mbarojmë pak më vonë, - tha duke treguar nga unë.

Burri me kostumin e zi doli duke më lënë mbi dyshemenë e shtëpisë që digjej. Shikoja flakët që përpinin grilat e dritareve dhe mendoja për jetën, për vdekjen, për gruan, për vajzën... për ato që ende nuk kisha arritur t'i bëja dot në jetë. *Në shtëpi do të isha të nesërmen në mëngjes.* Këmbët m'u bënë akull të ftohta, një dritë e bardhë, krejt e veçantë më mbështolli të tërin.

Mbylla sytë duke ndier kutërbimin e zjarrit dhe zhurmën e shtëpisë që po digjej.

DY

Dhjetë ditë më pas, New City.

- Mirë se erdhët detektivi Mirs. Besoj që kësaj radhe t'i keni sjellë dokumentet, - më përshëndeti togeri Ingru te hyrja e godinës.

- Po, - iu përgjigja duke i zgjatur dorën. - Më vjen keq për dje.

- S'ka problem. Gjëra që ndodhin.

Shtrënguam duart dhe ecëm nëpër korridor derisa mbërritëm te një dhomë as e madhe, as e vogël, me mure të bardha, të ndriçuar me llamba neoni. Në mes kishte një tryezë të gjatë me njëmbëdhjetë, a dymbëdhjetë karrige në njërën anë. Përballë saj gjendej një tryezë me dy karrige. Te ne, në Departament, Dhoma 207 shpesh cilësohej si “dhoma e inkuizicionit”. Gjatë karrierës sime kisha pasur rast ta njihja mirë.

- Kapiteni Benings do të drejtojë seancën dëgjimore, - tha togeri Ingru duke u drejtuar nga dera. - Ai ka punuar për ca kohë në zonën *Regional East* dhe prej dy muajsh e kanë emëruar këtu te ne. Është njeri i mirë.

U ula duke tundur kokën, me një buzëqeshje të shtirur, pasi e kisha më se të qartë kuptimin e fjalëve të tij. E dija, donte të më linte të kuptoja se kapiteni do të tregohej i butë dhe mirëkuptues, por nuk kisha çfarë të thosha. Departamenti i Policisë së New City-t, apo “Puna” siç e quanim ne, shpesh i ndryshonte rolet e atyre që merrnin dhe atyre që merreshin në pyetje. Ajo që më trazonte më tepër, duke u nisur edhe nga sa më kishin thënë përfaqësuesit e njësisë sime, ishte se kolegu im, detektivi Stiven Enri, ishte ende i zhdukur dhe unë duhej të përballesha me këtë seancë dëgjimore. “Puna” po e trajtonte këtë çështje në të vetmen mënyrë që njihnte, domethënë në mënyrë burokratike.

Togeri Ingru doli nga dhoma, dhe më la të shijoja “bukurinë” e vetmisë, e të vështroja

muret. Siç ndodhte gjithmonë në raste të tilla marrjesh në pyetje, mbi tryezë ishin vendosur një mikrofon dhe një kasetofon i vjetër, si edhe disa shishe të vogla me ujë dhe gota plastike. Vërtet për t'u habitur që në Departamentin tonë përdoreshin ende kasetofonë.

Pak minuta më pas Ingruja hyri në dhomë i ndjekur nga një burrë, që mbante uniformën e kapitenit të policisë.

- Detektivi Mirs, - tha kapiteni duke iu afruar tryezës sime e duke më zgjatur dorën.
- Jam kapiteni Benings dhe besoj se me togerin duhet të jeni njohur pak më parë. Sot do të procedojmë me dëgjimin tuaj.

U ngrita, i shtrëngova dorën, duke parë stemën e tij të ndritshme. Oficerët në detyrë, në përgjithësi e kishin për gjë të madhe të mbanin stema të vjetra, të nxira. Kjo do të thoshte se ato, e si rrjedhojë edhe oficerët që i mbanin, kishin parë e kishin kryer shumë punë të vështira në polici. Një stemë e pastër, e mbajtur qoftë edhe nga një kapiten,

zakonisht konsiderohej si tregues i një personi që kapej fort pas procedurave e që kishte shumë kohë të merrej me veten.

- Nisur nga çfarë ka ndodhur, po shoh që jeni përmirësuar, - vazhdoi ai.

- Faleminderit, por do të doja të bëja pjesë në skuadrën e kërkimit, - iu përgjigja duke i shtrënguar dorën.

- Kjo punë tashmë është organizuar. Për momentin, detyra jonë është t'i shkojmë deri në fund kësaj ngjarjeje të pazakontë. Si thoni?

Pohova me kokë me një buzëqeshje të shtirë, dhe u ula në karrige. Pata përshtypjen se ai e kishte ndarë mendjen qysh pa filluar.

Pa humbur kohë, kapiteni Benings shkoi te karrigia, zgjati dorën për nga kasetofoni dhe e ndezi.

- Sot është e premte, njëzet e tetë prill, - shqiptoi te mikrofoni dhe nxori një dosje si e imja. - Marrje në pyetje mbi rastin, ëh... 2016-208-224. Seancën e drejtojnë kapiteni Benings dhe togeri Ingru nga Zyra

e investigimeve të brendshme, e policisë së New City-t. Po dëshmon detektivi Robert Mirs nga Njësia operative ndërshtetërore.

Ngriti sytë dhe më vështroi.

- A jeni gati për të dëshmuar, detektiv?

- Them se po, - ia bëra duke hapur dosjen dhe duke e vendosur përpara mbi tryezë.

U ndjeva i befasuar. Kapiteni dukej sikur e kishte me ngut. Unë kisha të drejtën të paraqisja kundërshtime e të kërkoja praninë e një mbrojtësi, por mendova se njëlloj do të ishte.

- Parashtroni faktet duke nisur nga emri, pozicioni dhe njësia ku shërbeni.

U sistemova në karrige në mënyrë që t'i afrohesha mikrofonit dhe zura të flisja.

- Quhem Robert Mirs, punoj si detektiv pranë Njesisë operative ndërshtetërore. Bashkëpunojmë ngushtë me departamente të tjera dhe me Njësinë federale të investigimit për zgjidhjen e rasteve të vështira dhe të pazakonta që ndodhin, apo shqetësojnë New City-n. Detektivi Stiven Enri dhe unë

morëm një thirrje të drejtpërdrejtë telefonike për një kontroll në katin e pestë në *Liverstein Building*, në kryqëzimin e *Rrugës 30* me *Avenue 30*. *Liverstein Building* është një qendër tregtare shumëkatëshe ku ndodhen shumë zyra. Oficeri që na njoftoi, tha se në skenën e ngjarjes ishte gjetur një kufomë dhe duke u nisur nga rrethanat e pazakonta, detektivi i njësisë së zonës vendosi të na e kalonte rastin neve. Na u deshën rreth njëzet minuta të shkonim në vendngjarje. Mjeku ligjor kishte mbërritur para nesh.

Heshta për një grimë që të kaloja në faqen tjetër të bllokut me shënime dhe të pija një gllënjë ujë. Isha ende i emocionuar, sado që kisha kaluar sa e sa raportime të kësaj natyre.

- Trupi i pajetë gjendej sipër një tryeze, i veshur me rasë spitali. Më pas mësuam se atë kat e kishte marrë me qira një korporatë me emrin *Atlas*. Hetuam dhe zbuluam dokumentet e falimentimit, por u gjendëm në një rrugë pa krye.

Ngrita kokën dhe pashë se Ingruja dhe Beningsi po më vështronin në sy.

- Nga kontrolli i të gjithë katit doli se nuk përdorej prej shumë kohësh. Gjithçka, që nga mobiliat deri tek instalimet elektrike ishin me mbulesa plastike të trasha e të tejdukshme, përveç dhomës ku u gjend kufoma. Në të gjitha dhomat e tjera, sipër mbulesave kishte gati dy gisht pluhur. Ja disa foto që bëmë në skenën e krimit.

U ngrita, hodha disa hapa dhe i zgjata kapitenit një zarf të vogël.

- Të regjistrohet që detektivi më zgjati foto nga skena e krimit, - tha kapiteni te mikrofoni, duke hapur zarfin dhe duke anuar kokën për të parë fotografitë. Unë u ktheva te tryeza dhe u ula në karrige.

- Takuam disa punonjës dhe disa civilë, që punonin në atë ndërtesë, por nuk nxorëm gjë prej tyre.

- Çfarë kuptoni më konkretisht me këtë, detektiv? - pyeti kapiteni Benings.

- Oficerët e patrullës përgjegjëse të zonës më thanë se kishin qenë brenda ndërtesës për punë edhe më parë, por asnjëherë në

këtë kat. Po ashtu, edhe civilët që punojnë në atë ndërtesë thanë se në atë kat nuk kishin parë kurrë askënd që të hynte e të dilte. Nga një kërkim i mëtejshëm zbuluam se pikërisht ai kat kishte një shkallë private, e cila nga pjesa e pasme e godinës të çonte atje. Iu drejtua Departamentit të regjistrimeve, ku na konfirmuan se godina ishte ndërtuar në mënyrë të tillë qysh në vitin 1913.

- Të flasim pak për viktimën, - më ndërpreu kapiteni.

Vështrova përsëri nga komisioni dhe psherëtiva. Këto ndërprerje, ndonëse kapitenit mund t'i dukeshin të nevojshme, mua më mërznisnin, më hutonin. Pa përmendur pastaj faktin që ngjanin më tepër me një gjueti shtrigash sesa me një kontroll të paanshëm. Sepse, çfarë shqyrtimi mund të bëhej kur Stiveni nuk ishte gjetur ende?

I brengosur, ula kokën dhe pashë shëmbëllimin e fytyrës sime mbi syprinën e xhamtë të tryezës. Flokët e prerë shkurt ma tregonin kokën më të rrumbullakët se

ç'ishte dhe gërvishtja, që siç më thanë e kisha marrë duke u përleshur gjatë detyrës, po përmirësohej.

- Viktima, - ia nisa unë duke kërkuar nëpër fletët e dosjes ku kisha mbledhur shënimet e hetimit, - ishte mashkull, shtatmesatar, rreth një e shtatëdhjetë e pesë centimetra i gjatë. Në të gjithë trupin, përfshirë edhe gishtat, kishte shumë plagë. Sipër karriges gjetëm një kostum të zi, një këmishë të bardhë dhe një palë këpucë të zeza lustrafin, çorape dhe të brendshme, për të cilat menduam se i përkisnin atij. Çuditërisht, nuk gjetëm materiale që të na mundësonin të arrinim në përfundimin se ku mund t'i kishte marrë.

Heshta përsëri dhe vështrova kapitenin.

- Kam gjashtëmbëdhjetë vjet në këtë punë dhe diçka të tillë nuk e kisha parë, - vazhdova. - Përse ta kishin torturuar në atë mënyrë? Nuk e dimë. Në dhomë nuk kishte asnjë shenjë përleshjeje, çka të shtyn të hamendësosh se viktima ose kishte shkuar atje me dëshirën e tij, ose e kishin droguar.

Po ashtu, dyert dhe dritaret ishin të mbyllura, përveç njërës. Kjo të shtyn të mendosh që autori i krimit duhet ta ketë pasur çelësin.

- Detektiv, - më ndërpreu Beningsi, - sa hyrje ka në atë ndërtesë?

- Hm, është një hyrje kryesore, e cila të nxjerr në anën tjetër. Ajo hyrje të shpie te korridoret nga e majta në të djathtë. Në fund janë dy shkallë, të cilat të ngjisin në katin e pestë dhe është e pamundur të shkosh gjetkë.

- Faleminderit për sqarimin, ju lutem vazhdoni.

- S'ka përse, asgjë... Kthehemi te analizat e gjakut të viktimës. Nuk gjetëm gjurmë droge dhe nga analiza e ADN-së nuk doli të kishte qenë autor veprash kriminale. Nga ana tjetër nuk u arrit të identifikohesh dhe kështu e quajtëm Xhon Do.

Kapiteni dhe togeri më vështruan pa ndonjë interes, dhe unë vazhdova:

- Pak më vonë kryem marrjen e gjurmëve të gishtave të viktimës, por rezultati doli i njëjtë. Dukej se te gishtat kishte dy grupe

gjurmësh. Sidoqoftë, shkaku i vdekjes ishte goditje në zemër, shkaktuar nga dhimbja, sipas kontrollit mjekësor.

- A i patë dy grupet e gjurmëve? Si është e mundur? - pyeti Beningsi, duke kapsitur sytë.

- Për këtë nuk jemi të sigurt. Pa gjetur dot një term më të saktë mund të thoshim, se trupi ishte i mbushur me ndërhyrje, duke filluar nga të çarat e lëkurës e deri te disa deformime të kockave. Raporti që hartuam është pjesë e dosjes që keni edhe ju, dhe në të ndodhet një përshkrim i qartë i gjurmëve të gishtave. Megjithatë, do të doja të theksoja se eksperti përgjegjës për këtë analizë kishte mbetur goxha i habitur, sa përmendte prerje të forta të vijave të lakuara vertikale dhe horizontale në të dyja grupet e gjurmëve të gishtave, por edhe në gjurmët latente të tyre, - iu përgjigja.

Beningsi heshti, u pa sy më sy me Ingrunë, mandej vështroi nga unë.

- A gjetët tjetër gjë te viktimi? Ndonjë video nga kamerat e sigurisë aty rrotull, e

cila mund të hidhte dritë mbi ndonjë aspekt?

Unë heshta sërish për një copë herë. Pyetjet pa vend të Beningsit po më çorodisnin vërtet.

- Kontrolluam videot e tri ditëve të fundit të ndërtesave dhe godinave aty pranë, por viktimi nuk ishte futur në ndërtesë nga hyrja kryesore. Duhet të ketë përdorur shkallët sekrete, dhe ato nuk i kap asnjë kamera.

Kapiteni Benings pohoi me kokë.

- Mirë pra, vazhdoni!

Tre

Befas u hap dera dhe në dhomë u fut përfaqësuesi i njësisë sime.

- Nuk arrij ta besoj që e keni filluar raportimin pa mua, - tha me zë të lartë duke ardhur drejt tryezës.

- Zoti Li, - ia nisi kapiteni Benings, por përfaqësuesi e ndërpreu përsëri.

- Detektiv i nivelit të dytë, shumë faleminderit.

Lija rregulloi kravatën dhe u ul pranë meje te karrigia bosh.

- Ndërsa ju, kapiten, - vazhdoi, - duhet ta dini mirë se nuk mund të raportohet në një seancë dëgjimore pa qenë i pranishëm përfaqësuesi. Keni filluar? - më pyeti Lija, duke iu afruar mikrofonit.

- Po, - u përgjigja unë.